



**REPUBLIKA E MAQEDONISË VERIORE**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr. 03-212**

**16.06.2023**

**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonsë " nr. 184/13, 13/14, 44/14 , 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 55 paragrafët (5),(6) dhe (7) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1, datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2215/1, datë 23.5.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2414/6 datë 15.6.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 19- të mbajtur më 15.6.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për mënyrën që në shërbimi programor të SHTR TELEVISION SHPKNJP MAKPETROL Shkup, transmetuar më 8.5.2023, dy edicione të emisionit argëtues-dokumentar "Aventurat e Markut" nuk janë shënuar me sinjalizim për program që përmban marketing (plasim) të produkteve dhe në mënyrë specifike rekomandon shërbimet catering të restorantit "Staro/Zlatno Bure" dhe produktet e kompanisë (firmës) "Saša truffles", ndërsa edicionin e emisionit edukativo-argëtues "Garden club Gradini", ishin shënuar në mënyrë të papërshtatshme me sinjalistikën e përshkruar për program që përmban marketing (plasimin) e produkteve dhe në mënyrë të veçantë i rekomandonte produktet e kompanisë Nakayama.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2215/1 datë 23.5.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2.URDHËROHET SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe me Udhëzimin për zbatimin e dispozitave për marketing të produkteve.

3.Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4.Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë e miratimit konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuele.

**A r s y e t i m**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia ) në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspektin e respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe

të akteve nënligjore miratuar nga Ligji i njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në nenin 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) të LSHMAAV parashihet që në programet që përmbajnë marketing (plasim) të produkteve duhet të tregohet qartë se kemi të bëjmë me program në të cilin ka marketing (plasim) të produkteve. Këto programe duhet të ketë shenjë përkatëse në fillim dhe në fund të programit dhe gjatë vazhimit të programit pas çdo (shpice) reklamimi, në mënyrë që të shmangët konfuzioni midis shikuesve (paragrafi 5). Programet që përmbajnë marketing (plasim) të produkteve nuk duhet të inkurajojnë drejtpërdrejt blerjen ose marrjen me qira (huazim) të mallrave ose shërbimeve, veçanërisht nëpërmjet rekomandimeve të veçanta promovuese (paragrafi 6). Në programet që përmbajnë marketing (plasim) të produkteve nuk duhet t'i kushtohet rëndësi e tepruar (theksimi ose referenca) të produktit për të cilin bëhet fjalë (paragrafi 7).

Sipas Udhëzimeve për zbatimin e dispozitave për marketing të produkteve, programet që përmbajnë marketingun e produktit nuk duhet, nëpërmjet promovimit ose rekomandimit të hapur, të inkurajojnë drejtpërdrejt konsumatorët që të blejnë ose marrin me qira (huazojnë) produktet ose shërbimet. Produkteve ose shërbimeve që tregtohen në programe nuk duhet t'u jipet rëndësi e tepruar, duke i theksuar ose duke iu referuar atyre; (pika 21), edhe pse ndonjë produkt, markë, emër ose shenjë mbrojtëse tregohet në program, ekspozimi ose përmendja e tyre nuk duhet të bëhet në mënyrë të vayhdueshme, të tepruar ose fyese për promovimi të dukshëm të produktit, shërbimit ose markës; (pika 22), drejtuesit e programeve në të cilat (plasohen) tregtohen produkte ose shërbime duhet të shmangin reklamimin me fjalë për cilësinë, çmimin ose disponueshmërinë e produkteve ose shërbimeve, si dhe dhënien e çdo vlerësimi dhe rekomandimi pozitiv që i shtyn konsumatorët të blejnë ose të huazojnë produktet ose shërbimet e tregtuara; (pika 23), si dhe vlerësimi nëse programi përmban inkurajim të drejtpërdrejtë ose theksim të tepruar të ndonjë produkti ose përcaktim të shërbimit për çdo rast në veçanti, bazuar në cilindo nga kriteret e mëposhtme: karakteristikat e marketingut (plasimit), për shembull: hapësira e caktuar në ekran ose në studio, kohëzgjatja dhe ripërsëritja e reklamës ose shfaqjes; përshtatshmërinë dhe justifikimin e përmendjes ose paraqitjes në aspekt të konceptit editorial të programit konkret dhe gjuhës së përdorur gjatë reklamimit, domethënë mjeteve pamore gjatë prezantimit. (pika 24).

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 23 maj 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor ndaj SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup, transmetuar më 8 maj, 2023, në nivel shtetëror, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) të LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja e rregullt ndaj shërbimit programor të SHTR TELEVIZIJA MAKPETROL SHPKNJP Shkup transmetuar më 8 maj 2023, në nivel shtetëror, është konstatuar shkelje e nenit 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,

(paragrafi 5. - nëse programi përmban marketing (plasim) të produktit, duhet të tregohet qartë; paragrafi 6 - nuk mund të inkurajojë drejtpërdrejt blerjen ose marrjen me qira (huazim) të mallrave dhe shërbimeve nëpërmjet një rekomandimi të veçantë promovues; paragrafi 7 - produktit nuk duhet t'i kushtohet rëndësi e tepruar). Konkretisht, shkelja është kryer në atë mënyrë që në shërbimin programor të SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup, të transmetuar më 8.5.2023, dy edicione të emisionit argëtues-dokumentar "Aventurat e Markut" nuk janë shënuar me sinjalizimin përkatës për program që përmban marketing ( plasim) të produktit dhe janë rekomanduar shërbime katering në mënyrë promovuese nga restoranti "Staro/Zlatno bure" dhe produkte nga kompania (firma) " Saša truffles", ndërsa edicioni i emisionit edukativo-argëtues "Garden club Gradini" është shënuar pa sinjalizimin përkatës në vendin e papërshtatshme të programit që përmban marketing (plasim) të produkteve dhe rekomandim të veçantë të produkteve nga firma Nakayama.

Shkelja është kryer në dy edicione të emisionit argëtues-dokumentar "Aventurat e Markut" dhe në edicionin e emisionit edukativo-argëtues "Garden club Gardens", të specifikuar në faqet 2, 3 dhe 4 në pikën 7 të Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2215/1 datë 23.5.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TELEVIZIJA MAKPETROL SHPKNJP Shkup më datë 29.5.2023, dërgoi shkresë - Dorëzim raport me shkrim nga mbikëqyrja për deklaram ark.nr.10-2215/2 datë 29.5.2023, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2215/1 datë 23.5.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 1.6.2023. Në afatin e paraparë, pra më 1.6.2023, SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup, drejtuar Agjencisë ka dorëzuar Deklaratë me shkrim me Nr.y në ark.10-2215/3 datë 1.6.2022. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 16.9.2022 pasi shqyrtoi Raportin me shkrim dhe shkresën e dorëzuar - njoftimin me shkrim, konstatoi ndaj SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë - vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) nga Ligji i njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit. për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2215/1 datë 23.5.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02 -2414/6, datë 15.6.2023, për shkak të konstatimit të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.6.2023,

miratoi aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup ku detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe me Udhëzimin për zbatimin e dispozitave për marketing (plasim) të produkteve. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në bazë të nenit 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Shtojca (1):**

- Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2215/1 datë 23.5.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,**

---

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.